



Letër për prindër nr. 2

17.03.2020

Përkujdesja e fëmijëve nga prindërit, që nuk kanë të drejt për përkujdesje në një institucion të përkujdesjes së fëmijëve

INFORMACION I RËNDËSISHËM për përkujdesjen e fëmijëve në grupe të mëdha/ në grupet e firmave/ në vend të punës

MKFFI¹ dëshiron që t'i informojë prindërit sa më mirë në ditët dhe javët në vijim. Me këtë letër ju drejtohem në veçanti prindërve, që nuk kanë të drejt për përkujdesje në një institucion të përkujdesjes së fëmijëve

Ne i falënderojmë së pari për mirëkuptimin e plotë sipas pikëpamjes sonë, që ata kanë treguar në zbatimin e kësaj urdhërese për ndalimin e kontakteve. Ne e dimë, që ju ndodheni para një sfide të madhe në lidhje me përkujdesjen e fëmijëve tuaj. Ne e dimë, që për shumë prindër përkujdesja e fëmijëve ju ka sjellë para një situatë shumë të vështirë, për disa madje para një pikëpyetje të egzistencës. Eshtë pse ne kemi mirëkuptim për këtë, aktualisht ka prioritet të lartë ngadalësimi i përhapjes së koronavirusit. Për këtë arsye ju paralajmërojmë me urgjencë, që ju ta organizoni përkujdesjen e fëmijëve në atë formë, nga e cila rrjedhin kontakte të reja. Kjo e ndihmon edhe më tutje përhapjen e koronavirusit.

- Ju lutem **mos krijoni grupe të përbashkëta të përkujdesjes së fëmijëve në vendin e punës.**
- Ju lutem **mos krijoni grupe të përbashkëta të përkujdesjes së fëmijëve në sferën private.**

Këto forma të përkujdesjes i kundërshtojnë masat e mbrojtjes së infeksioneve

„Ndalesa e hyrjes në ofertat e institucioneve për përkujdesje të fëmijëve“.

1

¹ Ministria për Fëmijë, Familje, Refugjat dhe Integrim i Landit Nordrhein-Westfalen



Ju lutem që të përkujdeseni për fëmiun/fëmijët tuaj në vendin e punës, vetëm nëse **nuk krijoni një rrjet të kontakteve të reja.**

Ju lutem organizoni përkujdesjen me përgjegjësi të plotë dhe duke marrë parasysh rekomandimet e Institutit Robert-Koch. Ju lutem mos e leni fëmijët për përkujdesje tek gjyshet/gjyshët e tyre.

Ministri për Fëmijë dhe Rini Dr. Joachim Stamp është marrë vesh me ministrin e Ekonomisë Dr. Pinkwart, që ai ta sjellë këtë lutje urgjente edhe tek punëdhënësit tuaj. Ai do të proklamoj më tutje, që ata të bëjnë gjithçka, që përkujdesja e fëmijëve të mundësohet dhe të bëhet në shtëpi.

Ministria për Fëmijë, Familje, Refugjat dhe Integrim i Landit Nordrhein-Westfalen